

L I G J
Nr.9454, datë 21.12.2005

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në fund të pikës 5 të nenit 10 “Furnizimet e përziera” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Pika 5 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e shoqërive të ndërtimit, të cilat ndërtojnë për të shitur, pavarësisht nga fakti se sipërmarrësi i punimeve dhe investitori janë i njëjti person i tatueshëm. Në këtë rast furnizimi i procesit të ndërtimit është i tatueshëm, sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 2

Neni 20 “Toka dhe ndërtesat” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

1. Furnizimi i tokës dhe i truallit ose dhënia me qira e tyre është një furnizim i përjashtuar, përveç rasteve të shfrytëzimit për parking ose magazinim të mjeteve të transportit dhe të mjeteve të tjera lëvizëse.

2. Furnizimi i ndërtesave, përveç procesit të ndërtimit, është një furnizim i përjashtuar.

3. Dhënia me qira e ndërtesave, pronë publike, nga organet e pushtetit qendror ose vendor, është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 3

Neni 25/3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25/3

Shitja e librave, e gazetave, e revistave dhe shërbimet e reklamave në to

Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetat, furnizimi i gazetave, i revistave dhe i librave të çdo lloji, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar dhe nga media elektronike.”.

Neni 4

Pas nenit 25/6 shtohet neni 25/7 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/7

Furnizimet e shërbimeve të lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.”.

Neni 5

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Vlera minimale e tatueshme

Çmimi orientues minimal fiskal, për procesin e ndërtimit të banesave, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave pas këshillimit me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë.”.

Neni 6

Në nenin 31 shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) furnizimet e mallrave e të shërbimeve, në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve;”.

Neni 7

Në nenin 42 “Rishqyrtimet” fjalia e dytë e pikës 7 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 54 “Nxjerrja e tatimit të papaguar” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 54

Nëse TVSH-ja e detyruar, në mbështetje të këtij ligji, nuk është paguar deri në datën, në të cilën është e detyrueshme, organet tatimore kanë të drejtë të ndërmarrin veprime për të nxjerrë me forcë TVSH-në e detyruar, së bashku me interesat apo gjobat e vëna, sipas neneve 45 e 46 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Neni 9

Në nenin 57 paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Kur shkeljet e mësipërme nuk përbëjnë vepër penale, ato dënohen me gjobë. Ministri i Financave cakton me udhëzim kriteret e hollësishme për masën e dënimit me gjobë, sipas këtyre shkeljeve, në kushte e rrethana të përcaktuara.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu